UNIVERSITETI

"ISMAIL QEMALI" VLORË



RAPORTI VJETOR
2018 - 2019

Vlorë 2019

Përmbajtje

Pjesa I. Senati Akademik

Hyrje

I. Vlerësimi i përgjithshëm

II. **Bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte**

III. **Veprimtaria kërkimore-shkencore**
Politikat e kërkimit shkencor
Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien
Produktet në fushën e kërkimit shkencor
Produktet e kërkimit shkencor në Fakultetin e Shëndetit
Produktet e kërkimit shkencor në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe të Natyrës
Produktet e kërkimit shkencor në Fakultetin e Shkencave Humane
Produktet e kërkimit shkencor në Fakultetin e Ekonomisë

IV. **Të dhëna mbi programet e studimit**
Programet e studimit që ofron UV
Programet akademike në proces vlerësimi
Përshtatshmëria e programeve më misionin e institucionit

V. ***Të dhëna mbi aktet e brendshme***
Ndryshimet në Statutë
Rregullore të Brendshme

VI. **Të dhëna mbi Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**

VII. **Angazhimi i personelit akademik për vitin akademik 2018-2019**

VIII. **Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet**

Përqindja e punësimit të të diplomuarve 2019
Përqindjen e të diplomuarve që kaljnë provimin e shtetit dhe liçensohen 2019

IX. **Të dhëna për Këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**

X. **Vlerësime / Rekomandime për MASR**
Vlerësimi i përgjithshëm i komunikimit me MASR
Vlerësime / Rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore/nënligjore

XI. **Të dhënat mbi studentët**

Numri i studentëve të rregjistruar
Numri i studentëve të diplomuar
Numri i studentëve të shkëlqyer (Mesatare mbi 9.0)
Numri i studentëve të çrregjistruar transferuar (programi dhe fakulteti ku shkojnë)
Numri i studentëve që kanë përfituar bursa
Numri i studentëve që kanë përfituar nga përjashtimi / reduktimi i tarifave të shkollimit.
Numri i studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar (emri i programit)
Përqindja e studentëve kalues
Përqindja e studentëve që diplomohen

Vlerësim i përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve.
Vlerësimi i studentëve për secilin program dhe cikël studimi

Pjesa II. Bordi i Administrimit:

I. Të dhënat të përgjithshme mbi UV-në
Struktura e përgjithshme organizative
Njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese

II. Raporti vjetor financiar 2018

III. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik

IV. Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë
Kapacitetet akademike
Kapacitetet fizike infrastrukturore
Bibiloteka Shkencore
Politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë,

V. Të dhëna mbi audtimin e brendshëm.

I. Hyrje

Universiteti " Ismail Qemali" Vlorë , në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" paraqet raportin vjetor për vitin 2018-2019.

Raporti vjetor lidhur me veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin akademik 2018-2019, përputhet me kërkesat e

- Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor të institucioneve të arsimit të lartë në RSH",
- Udhëzimit të MASR, nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë"
- Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë,
- Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë,
- Planit të zhvillimit strategjik afatgjatë të UV-së.

Ky raport mbështetet në raportet/analizat vjetore të njësive kryesore dhe drejtorive të UV-së, përkatësisht**:**

- Relacionin mbi veprimtarinë e Fakultetit të Shëndetit gjatë vitit akademik 2018-2019 (shkresë Nr. 201/3 Prot., datë 20.09.2019),
- Raportin Vjetor të Fakultetit të Ekonomisë për vitin akademik 2018-2019(shkresë Nr.154/4 Prot., datë 23.09.2019),
- Raportin Vjetor i punës akademike dhe kërkimit shkencor të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe të Natyrës (shkresë Nr.327/2 Prot., datë 20.09.2019),
- Aktivitetin Akademiko-Shkencor, Fakulteti i Shkencave Humane, 2018-2019 (shkresë Nr.272/4 Prot., datë 20.09.2019).
- Raportin për Vitin akademik 2018-2019 të Drejtorisë së Edukimit pëe Cikin e Parë dhe të Dytë të Studimeve (shkresë Nr.1162 Prot, datë 20.09.2019).
- Raportin vjetor i punës së realizuar për vitin akademik 2018-2019 të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve (shkresë Nr.1140/1 Prot, datë 18.09.2019).
- Raporti vjetor i punës së realizuar për vitin akademik 2018-2019 të Sektorit të Bibliotekës Shkencore (shkresë Nr.1162/1 Prot, datë 01.10.2019).
- Raporti i veprimtarisë financiare të UV sipas udhëzimit nr. 5 datë 19.02.2018 (shkresë Nr.1210 Prot, datë 30.09.2019).
- Raporti Vjetor i punës së Njësisë së Auditit të Brendshëm (shkresë Nr.1239/1 Prot, datë 07.10.2019).

Gjithashtu, ai bazohet edhe në analizat e pasqyruara nga organet kolegjiale në UV (Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komsioni i përhershëm i dhënies së titujve).

Raporti synon:

- të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së IAL-së në zbatim të misionit të tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- të ofrojë informacion për ministrinë mbi gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që IAL-ja ofron;
- të nxitë dhe të rritë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron IAL;
- të paraqesë problemet e konstatuara nga IAL me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit.

PJESA I

SENATI AKADEMIK

I. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

UV është në një periudhë përcaktuese të historisë së tij 25 vjeçare, atë të krijimit të një vizioni të ri në përputhje me objektivat dhe progresin e vendit drejt integrimit në BE. Ky vizion duhet të marrë parasysh nevojat e tregut për figura profesionale të kualifikuara sipas standardeve ESCO të BE-së, të afta për të gjeneruar praktika të qëndrueshme zhvillimi në kontekstin europian.

Gjatë vitit akademik 2018-2019, Universiteti "Ismail Qemali" ka përmbushur synimet e planifikuara në lidhje me procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit ndaj shoqërisë. Strukturat akademike (senati, rektorati, fakultetet, departamentet, qendrat kërkimore-shkencore) dhe administrative të saj kanë bërë progres në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit, duke krijuar profilin e një universiteti i cili krijon dhe mbështet vlera të larta qytetare dhe humane. Edhe gjatë vitit akademik të referuar ai ka formuar dhe përgatitur, studentë premtues, profesioniste cilësorë në perputhje me trendin e tregut të punës, profesionistë ne shërbim të zhvillimeve dinamike në kontekstin rajonal e kombëtar duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore.

Shtylla kryesore në të cilat UV është mbështetur dhe ka zhilluar aktivitetin e tij edhe për gjatë vitit kademik 2018- 2019 janë:

1. **MËSIMDHËNIA DHE STUDIMI:** Në lidhje me procesin mësimdhënës, një vëmendje e veçantë iu kushtua përqendrimit të mësimdhënies tek rezultatet e të nxënit si dhe matjes të këtyre rezultateve. Në fund të çdo semestri, pedagogët iu nënshtruan vlerësimit nga ana e studentëve në lidhje me të gjithë parametrat e procesit të mësimdhënies dhe rezultatet e këtij vlerësimi u përdorën nga ana e autoriteteve drejtuese për të hartuar masat që duhet të ndërmere për të përmirësuar ato pika të theksuara nga ana e studentëve.
2. **PROFILI INSTITUCIONAL**: ka shfaqur progres të dukshëm në kryerjen e një roli drejtues në zhvillimin e arsimit, shkencës, sportit dhe kulturës duke përcaktuar ritmet e rritjes së ekonomisë dhe shoqërisë në rajon dhe më gjerë. Në këtë mënyrë, gjatë vitit akademik 2018-2019 kemi synuar të përmbushim ambicjet tona për të krijuar një Universitet udhëheqës në rajon, duke e kthyer atë në një pol të rëndësishëm zhvillimi, pararojë të inovacionit dhe të teknologjisë. Implementimi i kësaj strategjie do të realizohet

vetëm me pjesmarrjen aktive të studentëve, stafit akademik dhe ndihmës akademik, administrativ, shoqërisë civile, si dhe të gjitha palëve të interesuara (alumni, punëdhënësit etj).

3. **EDUKIMI I VLERAVE**: ka kryer një rol përcaktues dhe dominues në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike për integrimin e studentëve në jetën ekonomike, sociale e kulturore të rajonit e më gjerë. UV është një institucion që promovon e lufton për respektimin e vlerave themelore njerëzore dhe sociale. UV në këtë mision kërkon të integrojë pjesmarrjen e të gjithë aktorëve sipas qasjes europiane të sistemit ku qeverisja qendrore dhe lokale, institucionet akademike, perfaqesues te biznesit dhe shoqerise civile adresojne ne menyre te integruar nevojat e territorit dhe gjejne zgjidhje efektive per zhvillimin e tij.

4. **KËRKIMI SHKENCOR:** Ka vijuar të zhvillojë dhe të implementojë standartet më të larta për punë kërkimore shkencore bazë dhe të aplikuar me impakt ekonomik dhe social të fuqishëm në rajon. Edhe këtë vitë akademik, UV, ka vazhduar të mbështes financiarisht publikimin e artikujve shkencorë si dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit. UV, vit pas viti ka treguar jo vetëm ambicie për të qenë lider në rajon dhe më gjerë përsa i përket përgatitjes së brezave të rinj por gjithashtu një institucion me një histori mjaft pozitive në fushën e projekteve për rritje kapacitetesh dhe kërkim shkencor. Gjatë vitit akademik 2018-2019 Universiteti i Vlorës ka qenë patner në disa projekte që janë në implementim si dhe ka aplikura në një numër të konsiderueshëm projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. **INFRASTRUKTURA**: Ka përdorur në mënyrë efektive burimet ekzistuese njerëzore dhe logjistike të instituionit dhe ka bërë hapa në përmirësimin e vazhdueshëm dhe rritjen e kapaciteteve. Procesi mësimdhënës në të gjitha ciklet e studimit u krye në mjediset universitare në Godinat A, B dhe C. Ambjentet e marra me qera për zhvillimin e procesit mësimor të Fakultetit të Shëndetit kanë zgjidhur pjesërisht, sa për të dal nga situata e emergjencës problemin me **ambientet në dispozicion të studentëve dhe stafit për këtë fakultet**, por ndërtimi i një godine të re, me sipërfaqe të mjaftueshme për normativën e përcaktuar nga MASR, mbetet prioritet i rëndësishëm.

6. **BASHKEPUNIMI/PARTNERITETI**: Ka vijuar dhe thelluar më tej bashkëpunimet si partner aktiv në të gjitha veprimtaritë e arsimit të lartë në plan kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë vitit akademik 2018-2019 ka arritur të nënshkruaj dhe të jetë përfitues i një numri të konsiderueshëm marëveshjesh ndëristitucionale në kuadër të programeve Erasmus+ KA107 ICM dhe Mevlana të cilat kanë si qëllim shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik dhe ndihmësakademik/administrativ

7. **NDËRKOMBËTARIZIMI**. UV ka bërë progres të dukshëm dhe të matshëm në njohjen, prezencën dhe integrimin në zonën europiane të arsimit të lartë duke punuar në drejtim të internacionalizimit të instituionit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Për të rritur vizibilitetin dhe prezencëne në rajon dhe jo vetëm përgjatë vitit 2018-2019 UV ka arritur të nënshkruaj dhe një sër marrëveshjesh mirëkuptimi si dhe është anatërsuar në disa netëork-e në fushën e arsimit të lartë.

8. **SIGURIMI I CILESISË DHE STANDARTEVE**: Në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe europian për Arsimin e Lartë, UV, ka thelluar traditën e vetëvlerësimit të brendshëm, matjen dhe vlerësimin e punës së çdo njësie akdemike dhe administrative si dhe respektimin e një pune akademike të cilësisë së lartë në përputhje me standartet europiane ESCO të Komunitetit Evropian.

9. **ANGAZHIMI SOCIAL:** Ka realizuar me sukses një varg shërbimesh të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet, programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh për zhvillimin e studentëve dhe krijimin e profesionistëve të ardhshëm.

II. BASHKËPUNIME NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTE[1]

Në zbatim të skenarëve të zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë të Planit Strategjik të UV-së dhe më konkretisht të *Linjës strategjike Nr 1/ Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar* dhe *Linjës strategjike Nr 2/ Programe ndërkombëtare studimi dhe mobilitete afatgjata* pjesë e Skenarit të parë "Ndërkombëtarizimit", si dhe Strategjisë së ndërkombëtarizimit të UV-së, Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në bashkëpunim të ngushtë me fakultetet dhe departamentet e UV-së përgjatë vitit akademik 2018-2019 ka arritur të konkretizojë një numër të konsiderueshëm bashkëpunimesh ku vecojmë:

1. **Bashkëpunime ndërinstitucionale në kuadër të programeve me financim të huaj Erasmus + KA 107 International Credit Mobility.** UV përgjatë vitit akademik 2018-2019 ka arritur të nënshkruaj dhe të jetë përfitues i një numri të konsiderueshëm marëveshjesh ndëristitucionale në kuadër të programeve Erasmus+ KA107 ICM dhe Mevlana të cilat kanë si qëllim shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik dhe ndihmësakademik/administrativ.
   a. Në tabelën e më poshtme pasqyrohen të gjitha bashkëpunimet ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA107 ICM midis institucioneve të shteteve të ndryshme dhe UV-së.

Nr	Institucioni	Shteti	Periudha kontratës	Data e firmosjes	Fushat e bashkëpunimit	Detyrat e palëve	Rezultatet e pritura
1	Universiteti Shtetëror i Shkencave të Aplikuara Presidenti Stanisław Ëojciechoës ki në Kalisz *(The President Stanisław Ëojciechoës ki State University of Applied*	Polonia	2019-2021	06.09. 2019	• Administrim Biznesi • Teknologji Informacioni dhe Komunikimi • Inxhinieri Elektrike • Inxhinieri Mekanike	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ në Kalisz: -2 studentë për studime -1 studentë për trajnim **<u>Shkëmbim personeli:</u>**

[1] Referuar raportit vjetor të Drejtorisë së Sigurimit tëw Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve(DSBCP)

	Sciences in Kalisz)						Nga UV në Univ në Kalisz: -2 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim Nga Universiteti i Kalisz në UV: - 2 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim
2	Universiteti i Atikës Perëndimore *(University of Ëest Attica)*	Greqi	2020-2027		Të gjitha fushat	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. e Atikës: -2 studentë për studime. - 2 studentë për trajnim Nga Universiteti i Atikës në UV: -2 studentë për studime. - 2 studentë për trajnim **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në në Univ. e Atikës:

							-3 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim Nga Universiteti i Atikës në UV: - 3 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim
3	Universiteti i Bingolit *(Bingol University)*	Turqi	2014-2021	19.02. 2019	• Administrim Biznesi • Drejtësi • Gjuhë të huaja • Histori dhe Arkeologji • Matematik • Elektricitet dhe energji • Mekanik dhe metale • ICT • Biologji • Fizik • Kimi • Infermieri	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. e Bingolit: -5 studentë për studime. Nga Universiteti i Bingolit në UV: -5 studentë për studime **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. e Bingolit: -6 staf për mësimdhënje

							-6 staf për për trajnim Nga Universiteti i Bingolit në UV: - 6 staf për mësimdhënje -6 staf për për trajnim
4	Pomerian University in Slupsk	Polo ni	2019-2021	14.02. 2019			**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** -Nga UV në Univ. Pomerian: 8 studentë për studime. -Nga Univ. Pomerian në UV: - 8 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Pomerian: -8 staf për mësimdhënje Nga Univ. Pomerian në UV: - 8 staf për mësimdhënje
5	Universiteti Kazimierz Vielki	Polo ni	2019-2021	01.02. 2019	• Administrim	Palët angazhohen të kryejnë	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>**

	(Kazimierz Ëielki University)				biznesi dhe drejtësi • Shkenca natyrore Matematik dhe statistik	shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	Nga UV në Univ. e Kazimierzit: -6 studentë për studime. Nga Univ. e Kazimierzit në UV: -6 studentë për studime **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. e Kazimierzit: -3 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim Nga Univ. i Kazimierzit në UV: - 3 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim
6	Universiteti Ostravës *(University of Ostrava)*	Republika Çeke	2018-2021	16.01. 2019	• Literaturë dhe linguistikë	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. e Ostravës: -2 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>**

							Nga UV në Univ. e Ostravës: -1 staf për mësimdhënje. Nga Univ. i Ostravës në UV: - 1 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim
7	Universiteti i Edukimit në Vjenë (*Kirchliche Padagogische Hochschule Ëien/Krems*) KPHVIE	Austria	2016-2021	18.12. 2018	• Mësuesi Trajnim/ Shkenca Edukimi	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në KPHVIE -3 studentë për studime. Nga KPHVIE në UV: -1 studentë për studime **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në KPHVIE: -2 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim Nga KPHVIE në UV:

							- 2 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim
8	Universiteti Politeknik i Timisoarës *(Politehnica University of Timisoara)*	Rumani	2019-2021	07.12. 2018	• Gjuhë të Huaja • Teknologji Informacioni dhe Komunikimi • Inxhinieri kimike dhe proceset • Elektricitet dhe energji • Matematik • Mekanik dhe tregjet e metalit	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. Politek. i Timisoarës -12 studentë për studime. Nga Univ. Politek. i Timisoarës në UV: -12 studentë për studime **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Politek. i Timisoarës -7 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim Nga Univ. Politek. i Timisoarës në UV: - 7 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim

9	Universiteti "G. d'Annunzio " Kieti-Peskara *(Universita degli studi "G. d'Annunzio " Chieti-Pescara")*	Itali	2018-2021	03.12. 2018	• Literaturë dhe linguistik	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik	
10	Universiteti i Pitestit *(University of Pitest)*	Rumani	2018-2021	07.11. 2018	• Gjuhë të Huaja • Shkenca Edukimi	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Pitestit: -6 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim Nga Univ. i Pitestit në UV: - 6 staf për mësimdhënje -4 staf për për trajnim
11	Universiteti i Salernos *(University of Salerno)*	Itali	2018-2020	29.10. 2018	• Drejtësi	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. e Salernos: -4 studentë për studime. Nga Univ. i Salernos në UV:

							-4 studentë për studime **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. e Salentos: -2 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim Nga Univ. i Salentos në UV: - 2 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim
12	Universiteti i Atikës Perëndimore *(University of Ëest Attica)*	Greqi	2018-2020	29.10. 2018	Të gjitha fushat	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. e Atikës: -2 studentë për studime. - 2 studentë për trajnim Nga Universiteti i Atikës në UV: -2 studentë për studime. - 2 studentë për trajnim **<u>*Shkëmbim</u>**

							personeli: Nga UV në Univ. e Atikës: -3 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim Nga Universiteti i Atikës në UV: - 6 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim
13	Universiteti Iles Balears *(Universitat de les Illes Balears)*	Spanjë	2018-2020	23.10. 2018	• Literaturë dhe linguistik	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	***Shkëmbim studentor:** Nga UV në Univ. e Balears: -3 studentë për studime. ***Shkëmbim personeli:** Nga UV në Univ. e Balears: -3 staf për mësimdhënje Nga Universiteti i Balears në UV: - 3 staf për mësimdhënje

14	Universiteti Teknik Eskisehir *(Eskişehir Technical University)*	Turqi	2018-2021	08.10. 2018	• Elektronik Elektrike • Inxhinieri kompjuterike • Fizik • Matematik	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. Eskisehir: -8 studentë për studime. Nga Univ. Eskisehir në UV: -8 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Eskisehir: -8 staf për mësimdhënje -8 staf për për trajnim Nga Univ. Eskisehir në UV: -8 staf për mësimdhënje -8 staf për për trajnim
15	Universiteti i Anadolut	Turqi	2018-2021	28.10. 2018	• Administrim Biznesi • Ekonomiks • Manaxhim Turizmi • Drejtësi	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në UnivAnadolu: -14 studentë për studime.

					• Histori • Cikël i ulët • Mësimdhënie e Gjuhës Angleze		Nga Universiteti Anadolu në UV: -14 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Anadolu: -14 staf për mësimdhënje -14 staf për për trajnim Nga Univ. Anadolu në UV: -14 staf për mësimdhënje -14 staf për për trajnim
16	Universiteti Pavol Jozef Safarik në Kosice *(Pavol Jozef Safarik University in Kosice)*	Sllovaki	2018-2020	21.09. 2018	• Gjuhë të Huaja	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Kosice: -3 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim
17	Universiteti Zadar *(University of Zadar)*	Kroaci	2018-2020	21.09. 2018	• Gjuhë të Huaja	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. Zadar:

						personeli akademik dhe administrativ	-1 studentë për studime. ***Shkëmbim personeli:** Nga UV në Univ. Zadar: -5 staf për mësimdhënje Nga Univ. Anadolu në UV: -5 staf për mësimdhënje
18	Universiteti Jan Kocanovski në Kielce *(Jan Kochanoësi University in Kielce)*	Polo ni	2018-2021	18.09. 2018	• Gjuhë të Huaja • Edukim • Drejtësi	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	***Shkëmbim studentor:** Nga UV në Univ. Kielce: -2 studentë për studime. Nga Univ. Kielce në UV: -2 studentë për studime. ***Shkëmbim personeli:** Nga UV në Univ. Kielce: -2 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim

							Nga Univ. Kliece në UV: -2 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim
19	Universiteti Katolik ne Ruzomberok *(Catholic University in Ružomberok)*	Sllovaki	2018-2020	18.09. 2018	•Gjuhë të Huaja (Anglisht, Italisht)	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli akademik dhe administrativ	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. Ruzomberok: -3 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Ruzomberok: -1 staf për mësimdhënje -1 staf për për trajnim Nga Univ. Ruzomberok në UV: -3 staf për mësimdhënje -2 staf për për trajnim
20	Universiteti Eötvös Loránd (*Eötvös Loránd University*)	Hungari	2018-2020	18.09. 2018	• Gjuhë të Huaja	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe personeli	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. Eötvös:

						akademik dhe administrativ	-2 studentë për studime. Nga Univ. Eötvös në UV: -2 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. Eötvös: -2 staf për mësimdhënje Nga Univ. Eötvös në UV: -2 staf për mësimdhënje

b. Për herë të parë në UV-së u arrit këtë vit akademik nënshkrimi i 1 (një) marrëveshje në kuadër të programit MEVLANA me Universitetin e Bingolit (Bingöl University), në Turqi. Mevlana është një program mbi shkëmbimin e studentëve dhe personelit akademik midis Institucioneve të Arsimit të Lartë në Turqi dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë të vendeve të tjera në botë pavarësisht rajonit të tyre. Ai ka për qëllim të kontribuojë në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe rritjen e ndërveprimit kulturor. Në tabelën e më poshtme pasqyrohen detajet e marrëveshjes.

Nr	Institucioni	Shteti	Periudha kontratës	Data e firmosjes	Fushat e bashkëpunimit	Detyrat e palëve	Rezultatet e pritura
1	Universiteti i Bingolit *(Bingöl University)*	Turqi	2019-2024	2019	• Ekonomiks • Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	Palët angazhohen të kryejnë shkëmbim studentor dhe	**<u>*Shkëmbim studentor:</u>** Nga UV në Univ. e Bingolit:

					•Bilologji • Fizike • Kimi • Gjuhë të Huaja •Matematike •Juridik • Inxhinieri Elektrike •Inxhinieri Mekanike • Infermieri, Mami, Fizioterapi	personeli akademik	-42 studentë për studime. Nga Univ. Bingolit në UV: -38 studentë për studime. **<u>*Shkëmbim personeli:</u>** Nga UV në Univ. e Bingolit: -55 staf për mësimdhënje Nga Univ. Bingolit në UV: -55 staf për mësimdhënje

2. **Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU) dhe antarësime me institucione jashtë Shqipërisë të nënshkruara përgjatë vitit akademik 2018-2019.** Universiteti krahas nënshkrimit të marëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të programeve si Erasmus + apo Mevlana, për të rritur vizibilitetin dhe për të rritur prezencëne tij në rajon dhe jo vetëm, përgjatë vitit 2018-2019 ka arritur të nënshkruaj dhe një sër marrëveshjesh mirëkuptimi si dhe është anatërsuar në disa netëork-e në fushën e arsimit të lartë.
   a. Në tabelën e më poshtme pasqyrohen marrëveshjet (MoU) të nënshkruara ndërmjet UV dhe universiteteve të huaja me detajet përkatëse. Përfitues të këtyre marrëveshjeve janë stafi akademik dhe studentët e të 4- fakulteteve.

Nr	Institucioni	Shteti	Data e firmosjes	Vlefsh-mëria	Rezultatet e Pritura	Përfituesit
1	SUNY Fredonia University	Neë York, USA	26.08.2019	1 vit	Të zhvillojnë mundësitë e pritura nga projekti i USAID / Albania NextGen:	Universiteti i Vlorës – Fakulteti Ekonomik

					• Identifikimi i përmbajtjes dhe kërkesat e mundësisë së biznesit; • Përcaktimi i parametrave të biznesit, përfshirë marketingun, zhvillimin dhe kërkesat financiare. • Marrja e përgjegjësisë për të gjitha fushat e zhvillimit të biznesit të projektit, përfshirë identifikimin e konsulentëve të kualifikuar. • Përgatitja e trajnimeve, në bashkëpunim me Universitetin Amerikan, për pronarët e bizneseve të vogla dhe të mesme dhe punonjësit e nivelit të mesëm të qeverisë, siç specifikohet në Kërkesën për Propozim.	
2	Mendel University in BRNO	Republika Ceke	14.02.2019	5 vite	•Shkëmbim personeli për mësimdhënie dhe hulumtim. •Shkëmbim studentësh të gjithave niveleve. •Programe të përbashkëta kërkimore. • Shkëmbimi i materialeve shkencore, publikimeve dhe informacionit; •Veprimtari të tjera bashkëpunuese me interes të përbashkët të vendosur ose që do të zhvillohen.	Stafi akademik dhe studentët nga fakultetet: FSHH FSHT FSHP FE
3	Palacky University Olomouc	Republika Ceke	25.01.2019	5 vite	•Shkëmbim personeli për mësimdhënie dhe hulumtim. •Shkëmbimi i studentëve të programit Bachelor, Master dhe Doktoratë; •Shkëmbimi i stafit administrativ dhe profesional; •Sponsorizim i përbashkët i kurseve, tureve studimore, konferencave dhe seminareve;	Stafi akademik dhe studentët nga fakultetet: FSHH FSHT FSHP FE

					•Realizimi i projekteve të përbashkëta kërkimore përfshirë projektet e të financuara nga grante qeveritare dhe të tjera; •Shkëmbimi i informacionit dhe burimeve akademike që kanë interes reciprok.	
4	Universitas Sancti Cyrilli	Malta	25.10.2018	4 vite	•Shkëmbimi i stafit akademik dhe studentëve; •Pjesëmarrja në leksione gjatë vitit akademik ose shkollave verore, si seminare, ëorkshop-e dhe forma të tjera trajnimi të organizuara nga të dyja institucionet. •Zhvillimi i projekteve të përbashkëta, seminareve për studentët dhe alumni, konferenca, prezantime, mësim në distancë dhe aktivitete të tjera të rëndësishme akademike. •Shkëmbimi i informacionit akademik, arsimor dhe kërkimor; •Cdo lloj bashkëpunimi akademik, siç është dhënia e bursave, pasurimi i bibliotekës, udhëtimet me karakter arsimor në vendet e tjera, etj.	Stafi akademik dhe studentët nga fakultetet: FSHH FSHT FSHP FE
5	Universita Politecnica delle Marche	Itali	10.10.2018	1 vit	•Shkëmbimi i rezultateve dhe përvojave pedagogjike (seminare, kurse, etj) •Shkëmbim personeli për mësimdhënie, hulumtim. Pjesëmarrja e tyre në kurse, takime, seminare, konferenca si dhe shkëmbi i dokumenteve dhe që vijnë nga këto aktivitete. •Shkëmbim studentësh të gjithave niveleve	Stafi akademik dhe studentët nga fakultetet: FSHH FSHT FSHP FE

					•Zhvillimi i seminareve të përbashkëta, hulumtime shkencore, shkëmbimi i rezultateve e hulumtimit në mënyrë që të kryejnë konsultime shkencore, seminare, hulumtime, etj; •Ndarja e praktikave më të mira në lidhje me format dhe metodat e organizimit të procesit mësimor, prezantimi i teknologjisë së azhurnuar në procesin mësimor; •Zhvillimi i programeve speciale afatshkurtra akademike; •Veprimtari të tjera bashkëpunuese me interes të përbashkët të vendosur ose që do të zhvillohen.	

b. Universiteti i Vlorës është anëtar i disa rrjeteve universitare si:

- **EUCEN** është rrjeti i cili kontribuon në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore të Evropës përmes promovimit dhe avancimit të të nxënit gjatë gjithë jetën brenda institucioneve të arsimit të lartë në Evropë dhe gjetkë.
- **ASECU**- promovon nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e informacionit rreth planeve mësimore, shkëmbim të stafit mësimdhënës dhe hulumtues, shkëmbim studentë universitarë dhe pasuniversitarë etj, midis Universiteteve Ekonomike të Evropës Jugore dhe Lindore dhe të Rajonit të Detit të Zi.
- **BLACK SEA-** Rrjeti i Detit të Zi lidh kulturat dhe ekonomitë e Evropës, Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme për mijëra vite. Rrjeti është një iniciativë ndërkombëtare për mësimdhënie që lidh rajonet, disiplinat dhe institucionet duke krijuar programe arsimore dhe kërkimore që synojnë diversitetin e praktikave kulturore në një fushë shumë strategjike.
- **ENSP -** zhvillon një strategji për veprim të koordinuar midis organizatave aktive në kontrollin e duhanit në Evropë, duke ndarë informacion dhe përvojë përmes aktiviteteve të bashkërenduara dhe projekteve të përbashkëta.
- **CMU – (**Komuniteti i Universiteteve Mesdhetare) favorizon përparimin në shkencë, teknologji dhe kulturë si dhe stimulon marrëdhënie më të ngushta midis popujve të Mesdheut dhe zhvillimit të tyre civil dhe shoqëror.

- Prej 22 Mars 2019 UV është anëtar i Magna Charta Observatory.

Universiteti i Vlorës ka marrë pjesë në disa aktivitete që këto rrjete kanë organizuar, ku përmendim së fundmi pjesëmarrjen në konferencën e 8 ndërkombetare që organizohet nga më 15-20 Shtator prej University of National and World Economy (UNWE), Sofia, anëtar i ASECU, ku 2 studentë dhe 1 profesor do të prezantojnë punimet e tyre shkencore.

III. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

i. Politikat e kërkimit shkencor

- Universiteti i Vlorë është një institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt kërkimit shkencor. Roli i punës kërkimore është të mbështesë mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe të pasurojë përvojën si për studentët ashtu dhe stafin akademik. Universiteti i Vlorës inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare.

- Politikat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:

  - Angazhimin dhe përfshirje e stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore ndërkombëtare përmes ofrimit të mbështetjes financiare nga UV. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë dy herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto aktivitete
  - Bashkëveprim i qendrave kërkimore/shkencore në nivel fakulteti me të gjithë pedagogët.
  - Rritje e numrit të botimeve të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson reuter dhe/ose Scopus.
  - Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
  - Mbështetjen dhe zhvillimin e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe ëorkshop-eve në nivle departamenti dhe fakulteti si dhe bashkëpunim për organizimin e konferencave ndërkombëtare në partneritet me universitete prestigjioze Europiane.
  - Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
  - Rritje e bashkëpunimit staf akademik, student dhe komuniteti biznesit nëpërmjet takimeve, seminare, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
  - Organizim e Konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.

- Orientimi i UV drejt kërkimit shkencor është reflektuar në punën kërkimore shkencore të personelit akademik përmes pjeëmarrjes në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencor në revista me faktor impakti.

ii. Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Rëndësia e lidhjes së mësimdhënies me kërkimin shkencor është një kusht i domosdoshëm në konkretizimin e materialeve teorike në praktikë. Rëndësia e integrimit të kërkimit shkencor në mësimdhenie ka orientuar personelin akademik të UV-së në:

- Përditësimin e leksioneve të bazuara në shembuj konkretë të marrë nga tregu lokal, kombëtar dhe global.
- Përfshirjen e studentit në projekte të lëndës apo detyra kursi përmes sjelljes së rasteve të studimit apo praktikave nga realiteti shqiptar dhe më gjërë.
- Nxitjen e studentëve për organizimin e konferencave studentore
- Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konferenca, shkrimi dhe botimi i artikujve në revista janë një element tjetër tregues.

Duke patur parasysh ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, studentët janë nxitur vazhdimisht të përfshihen në punë kërkimore me qëllim nxitjen dhe kultivimin e kulturës së kërkimit gjatë viteve të jetës së tyre universitare, në mënyrë që të mund të fillojnë karrierën e tyre profesionale të mirëpërgatitur me ide dhe aftësi novatore.

Integrimi i studentëve në kërkimin shkencor ka qënë objektiv i proçesit kërkimor për vitin 2019. Kjo reflektohet dhe në mbrojtjen e diplomës me tezë ku studenti zhvillon një studim të caktuar nën udhëheqjen e stafit akademik.

Gjithashtu, studentët kanë qënë pjesë aktive edhe në veprimtaritë promocionale që fakultetet kanë zhvilluar jo vetëm me ofrim të shërbimeve por edhe me prezantime tematikash. Disa fakultete kanë organizuar për herë të parë konferenca studentore ku përmendim departamentin e Infermierisë me Konferencën e Parë studentore, me punimet shkencore ndër vite të të diplomuarve në programin e Masterit Shkencor në Shkenca Infermierore në FSH: "*Integrimi i i evidencave të kërkimit shkencor në përmirësimin e kujdesjeve infermierore".*

Përgatitja e Buletinit të studenteve nga Qendra Albanologjike dhe Ballkanistike e ngritur në Fakultetin e Shkecave Humane, është një tjetër evidencë e cila vlen të theksohet.

Studentët e Departamentit të Biologjisë janë aktivizuar në shumë aktivitete të ndryshme shkencore, seminaresh të hapura, ëorkshope etj. Vlen të përmendet aktivizimi i studentëve përkatësisht si më poshtë:

- Studentët e Ciklit të Dytë të Studime Master Shkencor "Biologji Mjedisore", kanë qënë pjesëmarrës aktiv ne trajnim mjedisor të realizuar qe është oraganizuar nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Rajonare Vlorë (AKZM), Drejtoria Vlorë (AdZM) dhe shoqata mjedisore APAWA (*Association for Protection of Aquatic Wildlife in Albania*), me qëllim monitorimin e mbetjeve detare në "Peisazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë", demostrimin e monitorimit të mbetjeve detare dhe kategorizimin e tyre sipas udhëzimeve të BE-së. Trajnimi lidhet me aspekte praktike të punës në terren, të cilat janë pjesërisht të lidhura edhe me kurrikulën universitare të programit Master Shkencor në "Biologji Mjedisore".

- Studentët e Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional 'Mësuesi AM në Biologji, me profil minor në Kimi" dhe Master Shkencor "Biologji Mjedisore" viti i parë, kanë qënë pjesëmarrës aktiv të një aktiviteti me tematikë "Promocioni Shëndetësor" të realizuar Në ambjentet e Fakultetit të Shkencave Teknike.

- Studentët e Vitit të dytë, Bachelor në Biologji organizuan një projekt me teme: "*Rëndësia e bimëve*".

- Gjatë muajit Tetor e Nëntor, pranë Qendrës Kërkimore Shkencore të FSHT u realizuan dy leksione të hapur nga Prof. të Universitetit të Tetovës, me tematikë: "*Aplikimi i metodave bashkëkohore në fushën e Biomjeksisë dhe anatomiko- histopatologjike, përvoja jonë në Laboratorin Hulumtuesh Shkencor Mjekësor të FSHM dhe në Institutin Ekologjik dhe Teknologjik në Universitetin e Tetovës*". Në këto leksion ishin të pranishëm stafi i Qendrës Kërkimore, pedagogë të Departamentit të Kimisë e Biologjisë si dhe studentë të Masterit Shkencor "Biologji Mjedisore".

- Në Departamentin e Biologjië është realizuar një leksion i hapur nga Dr. Simone Modugno, ekspert në Biologjinë Detare

- Në kuadër të Ditës Botërore të Biodiversitetit Departamenti I Biologjisë organizoi një Ëorkshop me përfshirjen e Studentëve

iii. Produktet në fushën e kërkimit shkencor

Aktiviteti kërkimor shkencor është një ndër shtyllat kryesore, ku mbështetet plani strategjik i UV-së dhe është bazë për balancimin e dijeve teorike me ato praktike. Zhvillimi i aktivitetit të kërkimit shkencor vijon paralelisht me aktivitetin e mësimdhënies dhe së bashku janë motorët e mirëfilltë të zhvillimit dhe ecurisë së duhur institucionale. Në këtë kontekst, aktiviteti i kërkimit shkencor zhvillohet përmes konferencave shkencore në nivel universiteti dhe fakulteti, pjesëmarrjes në projektet e programeve Evropiane si Erasmus+ dhe Horizon2020, angazhimeve në grupet e punës kërkimore shkencore në fushat më të rëndësishme të studimeve duke përfaqësuar Universitetin dhe vendin në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, hulumtimeve dhe publikimeve të artikujve shkencorë në Revistën shkencore të UV-së, si dhe përmes punës individuale shkencore të stafit akademik në departamente.

UV, gjatë vitit akademik 2018-2019 është angazhuar në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve shkencore me synimin e vetëm për të promovuar punën kërkimore dhe dijet e reja nga stafi i tij akademik. Në kuadër të aktiviteteve të organizuara përfshihen kongreset, konferencat, simpoziumet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Informacion më i detajuar për çdo fakultet, lidhur me aktivitetet shkencore për vitin akademik 2018-2019, pasqyrohet i detajuar si më poshtë vijon:

Produktet e kërkimit shkencor në Fakultetin e Shëndetit[2]

- Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015 në fillim të vitit 2017 çdo departament ka përcaktuar fushat e kërkimit shkencor specifik, mbi të cilat janë ngritur si tematikat e projekteve kërkimore, si temat e diplomave.
- Pedagogët tanë janë angazhuar në programe zhvillimi dhe kërkimore të BE si research associate (EUR-HUMAN project, Medical First Aid- IMO Model Course 1.14; Projekti MArED).
- Janë organizuar projekte të mirëfillta si studime fizibiliteti në të treja njësitë bazë.
- Në nivel fakulteti gjatë vitit akademik 2018-2019 janë botuar në total 31 artikuj të kategorisë full paper në revista ndërkombëtare me bord editorial të indeksuara në Pubmed, Thomson Reuters, Orcid etj me seli botimi në vendet e Bashkimit Europian (BE) dhe Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD).
- Stafi akademik i FSH është prezantuar me punime në 28 konferenca/aktivitete shkencore të zhvilluara jashtë vendit, kryesisht në vendet e BE dhe Ballkanit Perëndimor si dhe në 36 konferenca/aktivitete shkencore ndërkombëtare të zhvilluara brenda vendit, kryesisht në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Artikujt e botuar në revista brenda vendit përfshijnë botime kryesisht në Buletinin e Institutit të Shëndetit Publik dhe në Revistën Shkencore "Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor" Botim i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë.
- Midis njësive bazë të FSH vihet re frymë shumë e mirë bashkëpunimi në fushën e veprimtarisë kërkimore shkencore të botuar, që evidentohet në bashkautorësinë e shumë punimeve. U evidentuan dhe bashkëpunime me njësi të tjera kryesore të UV, kryesisht me Fakultetin e Ekonomisë.
- Puna shkencore vazhdon të mbetet në baza kryesisht individuale. Na mungojnë burimet financiare për të organizuar kërkime shkencore në bazë grupesh studimore, megjithë hartimin e disa projekt-propozimeve nga ana e stafit në këtë drejtim.

BOTIME SHKENCORE

1. **Jerina Çelaj, Glodiana, Sinanaj, Kristela Jaupaj, Brunilda Subashi, Fatjona Kamberi.** "Kanceri i stomakut dhe parandalimi i tij, duke njohur faktorët e riskut dhe metodat diagnostikuese" (2019). Botim simpoziumi. Botimet ADEA, Vlorë. ISBN 978-9928-4528-3-2**.**
1. **Fatjona Kamberi.** "Diagnoza Infermierore" (2018). Cikël Leksionesh. Edicioni i parë. Botimet Triptik, Vlorë. ISBN: 978-9928-245-10-6.
2. **Brunilda Subashi**. "Fizioterapia" (2018). Cikël leksionesh. ISBN 9780244733414. 124f.; 21x29.7c.
3. **Denada Selfo.** "Okulistikë-ORL" (2018). Cikël leksionesh. Botimet Ymeraj. Faqe: 211. ISBN 978-9928-283-03-0.
4. **Denada Selfo, Brunilda Subashi**. "Rreziqet profesionale ne sektorin shendetesor 1" (2018). Botim simpoziumi. Faqe: 74- ISBN: 978-0-244-03303-3
5. **Glodiana Sinanaj** ."Parandalimi i Melanomës – Mbrojtja efektive e shëndetit tuaj" (2018)

[2] Referuar raportit vjetor te FSH-së

Botim simpoziumi. Botimet: BenArt Print, Fier. ISBN 978-9928-4470-5-0.

6. **Denada Selfo;**Menaxhimi i Mbetjeve Spitalore dhe Ndikimi i Rreziqeve Profesionale në Mirëqenie; (2018) Botim simpoziumi. Botimet Benart. Faqe: 116- ISBN 978-9928-4470-4-3.
7. **Erion Koka, Sonila Nika** "Infermieria e aplikuar në shëndetin mendor" (2018) Cikël leksionesh. Botimet Europrint. Vlorë. ISBN9789995695026

ARTIKUJ SHKENCOR

1. **Enkeleint A. Mechili**, Charis Girvalaki, Aurela Saliaj, Filippos T. Filippidis, Constantine I. Vardavas. ËHO FCTC Article 14 enforcement in Albania: An urgent issue to tackle. *Tobacco Prevention & Cessation;* 2019;5 (February):6. DOI: https://doi.org/10.18332/tpc/103126
2. Christos Lionis, Elena Petelos, Sophia Papadakis, Ioanna Tsiligianni, Marilena Anastasaki, Agapi Angelaki, Antonis Bertsias, **Enkeleint-Aggelos Mechili**, Maria Papadakaki, Dimitra Sifaki-Pistolla, Emmanouil Symvoulakis. Toëards evidence-informed integration of public health and primary health care: experiences from Crete. *Public Health Panorama.* 2018; Vol. 4 (4):699-714.
3. Jirovsky E, Hoffmann K, Mayrhuber EA, **Mechili EA**, Angelaki A, Sifaki-Pistolla D, Petelos E, van den Muijsenbergh M, van Loenen T, Dückers M, Kolozsvári LR, Rurik I, Rotar Pavlič D, Sandoval DC, Borgioli G, Pinilla MJC, Ajduković D, De Graaf P, van Ginneken N, Doërick C, Lionis C. Development and evaluation of a ëeb-based capacity building course in the EUR-HUMAN project to support primary health care professionals in the provision of high-quality care for refugees and migrants. *Glob Health Action*. 2018;11(1):1547080. DOI: 10.1080/16549716.2018.1547080.
4. **Xhindoli J**. 2018, Organizzare le cure palliative, l'assistenza infermieristica per i malati nelle fasi avanzate delle malattie maligne nella città di Valona. IX PhD Day - Filling the Science Communication Gap - Seminars of the PhD in Infectious diseases, microbiology and public health. L'aula Pocchiari dell'Istituto Superiore di Sanità. ISSN: 0393-5620 online: 2384-857X.
5. **Xhindoli J,** Allushi E, Prifti V. 2018 "The consequences of violenze in the health care institutions" 1-2 June 2-nd International Scientific Conference On Technical Medical Sciences "Research And Education In Medical Sciences" (ICREMS) Shkoder; Fiorentia -ISBN 978-9928-191-69-4, pg.58.
6. **Xhindoli J,** Mamo Xh, Mucaj S, Peto E, Anziani: la qualità della vita e le loro esigenze nella città di Vlora. Scientific Bulletin - Special Edition, Università di Valona, StudioSai, Febbraio 2018. ISSN 2310-6719 pg.33-37.
7. Sinanaj S, Allushi E, **Xhindoli J,** Screening e prevenzione della talassemia maggiore nelle zone di Vlora, Fier, Lushnja, Kavaja e Saranda. Scientific Bulletin - Special Edition, Università di Valona, StudioSai, Febbraio 2018. ISSN 2310-6719 .
8. Muca S, Necaj L, Poloska A, Zyberaj B, **Xhindoli J.** Etica nella pratica infermieristica. Scientific Bulletin - Special Edition, Università di Valona, StudioSai, Febbraio 2018. ISSN 2310-6719.
9. **Denada Selfo,** Glodiana Sinanaj and Rozeta Luci. (2019). *The Importance of Steroid Therapy in Staphylococcal Marginal Keratitis ëith Hypopyon"* EC Ophthalmology 10 (8), 604-607 https://ëëë.ecronicon.com › pdf › ECOP-10-00498 Volume 10 Issue 8 - 2019.
10. **Denada Selfo**, Glodiana Sinanaj, Rozeta Luci. (2019). 6th International Scientific Conference "*Staphylococcal Marginal Keratitis Ëith Hypopyon* "Scientific Challenges for Sustainable Development 2019" **SCFSD Proceedings Book** ISBN 978-9928-4521-5-3.

11. **Evis Allushi**, Sonila Nika, Vasilika Prifti, Dajana Zeqiri (2019) "Identifying the risk that the nurse carries, recognizing this danger from nursing students. ISBN: 978 9928 4251-5-3 ; May 2019, Vlora, Albania The 6 –th International multidisciplinary Conference Multidisplinore Scientific Challenges for Sustainable Development .
12. **Evis Allushi**, Sonila Nika, Majlinda Zahaj, Vasilika Prifti. **(**2018). "Dekubituset, Rishikim literature në lidhje me menaxhimin infermieror", Konferenca e VI-të e profesionistëve të Shëndetit, Urdhri i Infermierit, Qarku Vlorë, "Infermieria dhe Shëndeti", ISSN 2310-6719 Special Edition.
13. **Rozeta Luci,** Denada Selfo,Glodiana Sinanaj (2019) *Evaluating Factors Affecting Early Prevention of Diabetes in Individuals in Vlora City,May 2018* "6th International Scientific Conference", Scientific Challenges For Sustainable Development 2019" SCFSD Proceedings Book.
14. **Majlinda Zahaj,** Rozeta Luci, Denada Selfo, Glodiana Sinanaj, Arberesha Gurguri, Inva Zotaj (2019) *"Evaluation Of Individuals Knoëledge About Diabetes And Treatment of Vlora Community In 2018* "6th International Scientific Conference", Scientific Challenges For Sustainable Development 2019" SCFSD Proceedings Book ISBN 978-9928-4521-5-3.
15. **Mimoza Canga,** Vito Malagnino, Giulia Malagnino, Irene Malagnino.(2019). In vitro evaluation of antimicrobial activity of Chlorhexidine and ozone gas against C.Albicans. ISSN: 0975-833X. International Journal of Current Research Vol. 11, Issue, 02, pp.1142-1146, February, 2019. DOI:https://doi.org/10.24941/ijcr.34277.02.2019.
16. **Mimoza C,** Vito MA.(2019). Evaluation of Caries Prevalence and Decayed-, Missing-, and Filled-teeth Values in Permanent Dentition in Children 7 to 10 Years Old-A Longitudinal Study. J Contemp Dent Pract. 2019 Jan 1;20(1):8-12.
17. **Rudina Çerçizaj,** Emirjona Kiçaj, Neritan Qirici (2019) "Clinical Teaching Values in Implementation of a Neë Model". EC Clinical and Experimental Anatomy 2.5: 204-211.
18. **Rudina Cercizaj**, Emirjona Kiçaj, Neritan Qieici, Ela Peto "Clinical Teaching values in implementation of a neë model" Journal of General Practice ISSN 2329 9126 DOI: 10.4172/2329-9126-C1-006 https://ëëë.omicsonline.org/proceedings/clinical-teaching-values-in-implementation-of-a-neë-model-75895.html
19. **Lalo, R**., & Kamberi, F. (2018). A Revieë of Cancer Research Studies in Albania: Hoë Publications Influence Cancer Prevention. Eastern-European Journal of Medical Humanities and Bioethics, 2(2), 31-42. https://doi.org/10.18662/eejmhb/13.
20. **Fatjona Kamberi, Eva Muhaj. (2019).** *Knoëledge and Health Beliefs of Nursing Students Toëard Human Papilloma Virus and Vaccine Use.* Asian Pac J Cancer Care, 4 (2), 27-32. DOI:10.31557/APJCC.2019.4.2.27
